

AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQERISE “SERVISMART” SHPK

Sot me date, 22.04.2024

- **ALESSIA DE MITRI**, atesia *Massimiliano*, shtetas italian, lindur me 31/07/1977, ne Roma(RM) Itali dhe banues ne Roma (RM), rruga “Via Filippo Cesare Annessi 5”, Itali, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me karten e identitetit italiane me Nr. AY1254273.
- **DANIELA BENDIA**, atesia *Edoardo*, shtetas italian, lindur me 12.08.1957, ne Roma(RM) Itali dhe banues ne Roma (RM), rruga “Via Filippo Cesare Annessi 5”, Itali, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me karten e identitetit italiane me Nr. AX9631332.

bazuar, ne legjislacionin ne fuqi vecanerisht, bazuar ne nenet 68 e vijues te ligjit nr. 9901 dt.14.04.2008 «Per Shoqerite Tregtare» i ndryshuar me ligjin nr. 129/2014 , Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 ”Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, LIGJ Nr. 131/2015 PER QENDRËN KOMBËTARE TË BIZNESIT, ne dispozitat e Kodit Civil ne cilesine e ortakeve themelues si dhe ne vullnetin tim te lire te shprehur dhe ne nenshkrimin e akteve te themelimit te shoqerise kemi hartuar aktin e themelimit dhe statutin e nje Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar (me poshte shoqeria):

KREU I THEMELIMI , EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA

NENI 1 DATA E THEMELIT, EMRI I THEMELUESIT

1. Sot ne date 22.04.2024, u themelua shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emrin

“SERVISMART” SHPK

2. Themeluesit e shoqerise jane:

- **ALESSIA DE MITRI**, atesia *Massimiliano*, shtetas italian, lindur me 31/07/1977, ne Roma (RM) Itali dhe banues ne Roma (RM), rruga “Via Filippo Cesare Annessi 5”, Itali, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me karten e identitetit italiane me Nr. AY1254273.
- **DANIELA BENDIA**, atesia *Edoardo*, shtetas italian, lindur me 12.08.1957, ne Roma (RM) Itali dhe banues ne Roma (RM), rruga “Via Filippo Cesare Annessi 5”, Itali, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me karten e identitetit italiane me Nr. AX9631332

AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQERISE “SERVISMART” SHPK

NENI 2 OBJEKTI I SHOQERISE

Objekt i kesaj shoqerie do te jete:

1. përpunimin e të dhënave të kontabilitetit, të dhënave administrative në përgjithësi dhe, për më tepër, të asistencës së nevojshme. shoqëria ofron shërbime të çdo lloji e natyre që i përgjigjen ekzigjencave operative dhe të përkohshme jo vetëm për profesionistët, studimet profesionale, por edhe për të tjerë, siç janë, shoqëritë, entet, trustet, shoqatat, organizatat për kompanitë, si edhe për zyrat private në përgjithësi;
2. përpunimin e pagesave për punonjësit dhe bashkëpunëtorët si për entet publike ashtu edhe për ato private;
3. asistencë dhe mirëmbajtjen e dokumentave dhe shikimin e tyre pranë zyrave publike e private
4. administrimin e agjencive nëpërmjet praktikave administrative për llogari të të tretëve
5. organizimin dhe menaxhimin e zyrave përmes shërbimeve të sekretarisë;
6. çdo lloj operacioni dhe furnizimi në sektorët e informatikës dhe kompjuterave, si për softwaret ashtu edhe për hardwaret;
7. menaxhimin e marrëdhënieve të sponsorizimit dhe reklamave, në fushën e veprimtarive konkurruese në fushën e ngjarjeve sportive e kulturore, kërkimit dhe shitjes së hapësirave dhe të shërbimeve promovuese e reklamave, blerjen nën kujdes të pjesshëm e të plotë të administrimit të markave të korporatave vetëm për qëllime reklamimi që lidhen me veprimtarinë e tyre kryesore; realizimin, shitjen, marketingun dhe shpërndarjen e pajisjeve, objekteve dhe veshjeve sportive të cilat do të mbajnë mbishkrimin e markave e logove të kompanive aktuale e të të tretëve;
8. prodhimin, blerjen, shitjen, in block apo ndarazi të pronave urbane, të zonave periferike, industriale, tregëtare, rezidenciale, të impianteve sportive, të pajisjeve të hotelerisë apo strukturave të ngjashme me anë të berjes apo marrjes me qera me qëllim përdorimi, dhënies me konçesion tek të tretët në vendndodhje, përdorimit dhe dhënies me qera të pasurive të paluajtshme, të impianti eve dhe të pajisejve;
9. administrimin e pasurive të luajtshme e të paluajtshme;
10. ofrimin e shërbimeve të konsulencës së marketingut e reklamave për kompanitë, privatët, entet dhe institucionet;
11. ideimin, prodhimin dhe shpërndarjen e objektve me markë të dedikuar;
12. administrimin e call center në përgjithësi;

AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQERISE “SERVISMART” SHPK

13. ndërmjetësimin e shërbimeve në sektorin e shëndetsisë, shitjen e aparaturave të shëndetsisë;
14. asistencë të specializuar dhe të përgjithshme si në shtëpitë e pleqve në përgjithësi, ashtu dhe në dhoma në veçanti;
15. konsulencë për menaxhimin dhe hapjen e spitaleve, studiove mjekësore, klinikave, shtëpive të pleqve, stabilimenteve të ujrave termale, salloneve të bukurisë dhe palestrave, strukturave pritëse në përgjithësi, edhe të llojit turistik hotelierisë për të moshuarit e jo vetëm, edhe përmes përdorimit, e në fund, për personelin e specializuar e jo vetëm.
16. Cdo aktivitet tjetër të lidhur me aktivitetin kryesor.

Per te gjitha aktivitetet qe kerkojne licenca te vecanta shoqeria do te angazhohet qe tani per te plotesuar kerkesat e ligjeve te posacme.

NENI 3

KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e shoqerise do te jete deri ne nje afat te papercaktuar.

Shoqeria mund te prishet perpara ketij afati me vendim te asamblese se Ortakeve.

NENI. 4

SELIA E SHOQERISE

Selia e Shoqerise eshte ne adresen: Rruga Norbert Jokl, Ndertesa Nr. 2, Hyrja 1, Njesia Administrative Nr. 2 Tirane.

KREU II

KAPITALI

NENI 5

KAPITALI I REGJISTRUAR

Kapitali i regjistruar i shoqerise do te jete 1.200.000 (njemilion e dyqind mije) leke i perbere nga 2 (dy) kuota.

Pjesemarrja e ortakut themelues ne kapitalin e shoqerise eshte:

Kontributi ne kapitalin e shoqerise zoterohet nga Ortaket ne masen :

- ***ALESSIA DE MITRI, atesia Massimiliano, shtetas italian, lindur me 31/07/1977, ne Roma(RM) Itali dhe banues ne Roma (RM), rruga “Via Filippo Cesare Annessi 5”, Itali, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me karten e identitetit italiane me Nr. AY1254273, zoteron nje kuote sa 51% të kuotave me vlere 612,000 leke.***

AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQERISE “SERVISMART” SHPK

- **DANIELA BENDIA**, atesia Edoardo, shtetas italian, lindur me 12.08.1957, ne Roma(RM) Itali dhe banues ne Roma (RM), rruga “Via Filippo Cesare Annessi 5”, Itali, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me karten e identitetit italiane me Nr. AX9631332, zoteron nje kuote sa 49% të kuotave ne vleren 588,000 leke.

Kontributi i ortakut do te jete ne para.

NENI 6 ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit te regjistruar per kontribute ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin e regjistruar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohet per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi prek ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqsojne.

NENI 7 TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo te kalohen si me poshte:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Cdo menyre tjeter percaktuar ne ligj.

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme midis ortakeve.

Pjeset e kapitalit te regjistruar jane te transferueshme me rruge trashegimije, sipas parashikimeve ligjore.

KREU III ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

NENI 8 ORGANET VENDIMARRESE

AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQERISE “SERVISMART” SHPK

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmares i shoqerise.

Asambleja e pergjithshme eshte kompetente per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet si me poshte:

- a. Percaktimi i politikave tregtare te shoqerise
- b. Ndryshimet e statutit
- c. Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- d. Emerimin dhe shkarkimin e likujdatoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar
- e. Percaktimi i shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c) e d)
- f. Mbikqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
- g. Miratimi,i bilanceve
- h. Zmadhim dhe zvogelim kapitali
- i. Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- j. Perfaqesimin ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve
- k. Riorganizimi dhe prishja e shoqerise
- l. Miraton rregulla proceduriale te mbledhjeve te asamblese
- m. Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete. Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

NENI 9

THIRRJA E MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithë ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese

Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortakët jane dakort, per te marre vendime, pavaresisht parregullise.

NENI 10

KUORUMI

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortakët, qe zoterojne me shume se 30 % te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per tregetarët dhe Shoqerite tregetare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortakët qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQERISE “SERVISMART” SHPK

Nese kuorumi i permendur ne paragrafin e mesiperm nuk arrihet, asambleja e pergjithshme, mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

NENI 11 MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e pergjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ e votave te zoteruesve te kapitalit te ortakeve pjesmarres, per ndryshimin e statusit zmadhimin ose zvoglimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizmin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres, per ceshtjen te tjera.

Cdo ndryshim duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne regjistrin e shoqerise.

NENI 12 PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendimin pet:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij
- c) ngritjen e nje padije ndaj tij nga shoqeria
- d) dhenien ose jo te perfitimeve te reja

Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konfikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

NENI 13 ADMINISTRIMI

Asambleja e pergjithshme emeron nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet me te drejte riprteritje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne QKB.

Personi i meposhtem caktohet si Administrator i pare i shoqerise, duke patur te drejta te pakufizuara administrimi:

ALESSIA DE MITRI, atesia Massimiliano, shtetas italian, lindur me 31/07/1977, ne Roma (RM) Itali dhe banues ne Roma (RM), rruga “Via Filippo Cesare Annessi 5”, Itali, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me karten e identitetit italiane me Nr. AY1254273.

AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQERISE “SERVISMART” SHPK

NENI 14 KOMPETENCAT E ADMINISTRATOREVE

Administratoret kane te drejte dhe detyrohen te:

- a) Kryejne te gjitha veprimet e administrimit te vendosura nga asambleja e pergjithshme duke zbatuar politikat tregetare
- b) Perfaqesojne shoqerine
- c) Kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel te shoqerise
- d) Pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe
- e) Raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, I paraqesin keto dokumente perpara Asamblese se Pergjithshme per miratim
- e) Krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise
- f) Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhena e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit
- g) Raportoje para Asamblese se Pergjithshme nepermjet relacioneve mbi zbatimin e politikave tregetare dhe te veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise
- h) Kryejne detyra te tjera te parashikuara nga ligji dhe statuti.

Asambleja e pergjithshme mundet ne cdo moment, te shkarkoje administratorin me shumice te thjeshte te votave. Statuti ose rregullore te tjera nuk mund ta kufizojne ose heqin kete te drejte.

NENI 15 PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT

1. Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise. Administratoret te cilet kane kryer veprimet ose bere marreveshje te pa aprovuara nga asambleja, jane pergjegjes per demet e sjella shoqerise dhe pergjigjen personalisht ose solidarisht per pasojat.
2. Nese administratori vepron ne kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale eshte i detyruar ti demshperbleje shoqerise demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes si dhe ti kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregulta.

KREU IV VITI FINANCIAR –EKSPERTET

NENI 16 VITI FINANCIAR

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon ne 31 Dhjetor, Perjashtimisht , viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB dhe mbyllet me 31 dhjetor

AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQERISE “SERVISMART” SHPK

NENI 17 EKSPERTET

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, dhe atë në lidhje me kontrollin periodik të ushtruar prej tij, për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë të ngarkuar nga ana e ortakëve. Në përbushje të kësaj detyrë eksperti kontabel i autorizuar përfaqëson raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe atë për kontrollin periodik të ushtruar.

KREU 5 PRISHJA DHE RI-ORGANIZIMI I SHOQERISE

NENI 18 PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Shoqëria konsiderohet e shpërndarë kur:

- a. Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar e shoqërisë
- b. Me vendimet e asamblese së Ortakëve
- c. Me hapjen e procedurave të falimentit
- d. Nëse nuk zhvillon aktivitet tregtar për 2 vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007 Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit,
- e. Me vendim gjykatë.

NENI 19 RIORGANIZIMI I SHOQERISE

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblese së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit mbi shoqëritë tregtare.

NENI 20 KLAUZOLA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Ortakët dhe administratorët e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, nuk mund të mbajnë pozicionin drejtues apo të jenë të punësuar në një shoqëri që ushtron aktivitet në të njëjtën fushë me të parën. Ndalimi i pikës 1 mund të anulohet në asamblet e pare të përgjithshme me ³/₄ e votave në sipas dispozitave të nenëve 87 dhe 145 të ligjit për shoqëritë tregtare.

NENI 21 LEGJISLACIONI

AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQERISE “SERVISMART” SHPK

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me statutin, legjislacionin shqiptar dhe ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

NENI 22 MOSMARRVESHJET

Per mosmarrveshjet midis ortakeve te shoqerise, ose shoqerise me te tretet, gjykata kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata Shqiptare..

Ky akt, u redaktua ne 3 kopje ne gjuhen shqipe dhe ne gjuhen italjane, me vlere te njejte ligjore.

ORTAKET THEMELUES

ALESSIA DE MITRI

Alessia De Mitri

De Mitri

DANIELA BENDIA

Daniela Bendia

Bendia